


Bashkia Kamëz



Raporti Performancës 2020



Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2020 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2020 të Bashkisë Kamëz.

https://public.tableau.com/vieës/Kamez-RaportiInteraktiv2020/Tedhenatadministrative?:language=en&:display_count=y&publish=yes&:origin=viz_share_link

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Kamëz me asistencën e Projektit Bashki të Forta një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

Përmbajtja

Fjalor shpjegues.....	3
Të dhëna të përgjithshme	5
Burimet e Financimit.....	6
Shpenzimet buxhetore.....	7
Investimet.....	8
Treguesit Financiar	9
Administrimi i bashkisë.....	10
Rrjeti rrugor rural	12
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët.....	16
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	17
Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve	19
Menaxhimi i mbetjeve	22
Shërbime publike vendore.....	24
Stehimi social.....	26

Fjalor shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

Tregues të performancës së programeve buxhetore. Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshebull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

Treguesit kyç financiarë – llogaritja dhe domethënia e tyre:

- **Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave.** Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave. Me pak ndryshime raporti tregon sesa shpenzon bashkia për të ofruar një Lek shërbime publike.
- **Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave.** Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Në këtë tregues nuk përfshihen të ardhurat e trashëguara

nga viti i kaluar. Një raport i lartë është pozitiv për bashkinë pasi tregon se ajo nuk mbështetet në burime të jashtëme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.).

- **Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ndaj totalit të të ardhurave.** Tregon kapacitetin fiskal të bashkisë. Një normë e lartë mund të sygjerojë jo vetëm mbledhjen e mirë të detyrimeve fiskale por edhe taksa apo tarifa të larta.
- **Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifave vendore ndaj planit të tyre.** Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë bëhet e përhershme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore që mund të jetë për shkak të procedurave, barrës së lartë fiskale, ose parashikim i pasaktë.
- **Norma e shpenzimeve për investime kapitale ndaj totalit të shpenzimeve.** Një normë e lartë tregon një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore.
- **Norma e shpenzimeve për personelin ndaj totalit të shpenzimeve.** Rritja e shpenzimeve për personelin mund të tregojë se shpenzimet po rriten më shumë sesa të ardhurat (pasi zakonisht kostot e personelit kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore të bashkisë).
- **Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave.** Huaja afatgjatë i referohet një periudhe më të madhe sesa një vit. Një normë e ulët tregon se bashkia është e aftë t'a paguajë borxhin sipas afatit të caktuar. Një normë e lartë mund të sygjerojë se bashkisë do t'i duhet të ulë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në mënyrë që të shlyejë borxhin.
- **Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave.** Detyrimet e vonuara janë pagesa që bashkia nuk ia ka bërë të tretëve brenda afateve ligjore (kontrata; fatura të papaguara etj.). Një normë e lartë tregon mundësinë financiare të bashkisë nga të ardhurat e saj për të respektuar detyrimet kundrejt të tretëve.
- **Norma e shpenzimeve për politikën sociale ndaj totalit të shpenzimeve.** Një normë e lartë tregon ndërmarrjen e politikave të reja ose masa në fushën e shërbimeve sociale ose rritje të numrit të përfituesve të këtyre politikave/masave.

Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

Përmirësim



Përkeqësim



E njëjta situatë



Nuk ka informacion



Bashkia Kamëz

Bashkia Kamëz e pozicionuar në qendër të vendit përbëhet nga 2 Njësi Administrative: Kamëz dhe Paskuqan me sipërfaqe prej 38.5 km². Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Kamzës. Popullsia e bashkisë numëron 104,190 banorë (sipas të dhënave të Censurit) me një përfaqësim gjinor 50.2% femra dhe 49.8% meshkuj. Bashkia ka një numër total familiesh prej 29,770 nga të cilat 64% në pjesën urbane dhe 36% në pjesën rurale të bashkisë. Rrjeti rrugor prej 932.42 km linear shtrihet në rreth 153.2 km në pjesën urbane të saj. Gjatë vitit 2020 u shënuan 725 lindje dhe 618 vdekje duke pasur një raport pozitiv të rritjes së popullatës për gjithë bashkinë.


Bashkia drejtohet në mandatin e parë të tij nga Kryetari **Rakip Suli**, gjatë zgjedhjeve të fundit vendore morën pjesë rreth 11.12 % e zgjedhësve.

Viti 2020 shënoi një vit të vështirë për ekonominë e bashkisë dhe shëndetin e popullatës për shkak të situatës Pandemike që është prezente tashmë në mbarë botën. Bashkia u mundua t'i qëndrojë pranë komunitetit sidomos shtresave në nevojë si edhe duke lehtësuar barrën fiskale të biznesit të vogël.

Është për t'u theksuar se gjatë këtij viti bashkia i ka ardhur në ndihmë familieve të dëmtuara nga tërmeti të cilat kanë përfituar bonos (grant për qeranë e përkohshme) si edhe ndërtimin e banesave apo apartamenteve si financim nga qeveria qendrore nëpërmjet bashkisë. Shumat totale të financimit janë rreth 520 milionë lekë të disbursuara deri në fund të vitit 2020.

Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (000 Lekë)		FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI 2020 në %
		2,306,348	2,413,375	2,566,957	2,869,514	89%
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Fakt Vs Plan 2020 në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat e ndara	25,892	49,849	55,116	65,755	84%
	Të ardhura nga taksat lokale	331,508	375,819	225,543	488,321	46%
	Të ardhura nga tarifa vendore	436,756	387,873	254,046	309,792	82%
	Të ardhurat e tjera	166,434	142,421	103,756	35,435	293%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e kushtëzuar	624,349	688,023	1,163,720	1,205,435	97%
	Transferta e pakushtëzuar	478,714	494,970	504,614	504,614	100%
	Transferta specifike	140,129	171,748	173,047	173,047	100%
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi me destinacion	6,875	8,119	22,621	22,621	100%
	Trashëgimi pa destinacion	95,691	94,553	64,494	64,494	100%



Bashkia vazhdon të këtë një financim që varet në mbi 70% nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit luhaten në kufijtë 25 - 42% të të gjitha të ardhurave të bashkisë. Viti 2020 shënoi rënien e kontributit të të ardhurave nga burimet e veta duke reflektuar kështu situatën e vështirë pandemike për familiet dhe biznesin e bashkisë. Burimet e financimit gjatë vitit 2020 tregojnë se:

- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë u rritën me 6% kundrejt vitit 2019 ku ato nga taksat, dhe tarifat lokale u ulën me 33%;
- ✿ Totali i burimeve të financimit të bashkisë u realizua në masën 89% kundrejt planit për vitin 2020.

Figura 1. Peshë e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Shpenzimet buxhetore

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT (000 Lekë)	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI NË %
	2,017,845	2,323,693	2,431,770	2,869,515	85%
Rrjeti rrugor rural	699,071	812,257	514,634	611,640	84.14%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijet	470,354	449,722	509,851	510,604	93.52%
Zhvillimi strehimit	77,628	58,345	215,358	51,219	420.47%
Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve	176,006	284,481	191,774	252,751	67.87%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	202,706	83,838	123,754	182,348	62.82%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	67,500	112,500	97,383	155,016	96.15%
Menaxhimi i mbetjeve	111,157	143,802	92,032	125,331	88.30%
Sherbime publike vendore	0	30,481	38,294	39,828	63.07%
Çështje financiare dhe fiskale	881	34,675	35,127	39,781	96.15%
Planifikimi Urban Vendor	14,536	11,859	35,092	55,642	88.30%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	21,511	25,640	33,695	34,140	63.07%
Arsimi profesional	0	13,078	19,836	21,616	91.76%
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe m...	0	18,264	18,264	18,264	100.00%
Blerje Ndertesash për të demtuarit nga ter...	0	13,770	17,313	17,601	100.00%
Sherbimet e Policisë Vendore	8,083	16,713	16,343	23,462	67.07%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike d...	14,450	16,030	14,898	22,212	97.30%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	9,392	10,157	13,698	14,078	70.71%
Gjendja civile	24,627	6,254	6,619	26,580	100.00%
Sport dhe argëtim	0	93,438	6,367	5,057	100.00%
Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi ...	114,538	27,196	2,085	19,299	100.01%
Furnizimi me ujë	0	58,001	1,006	1,006	100.01%
Emergjencja civile	0	0	500	500	100.01%
Menaxhimi i infrastruktuës së ujitjes dhe k...	0	0	0	0	0%
Programet e zhvillimit	0	0	0	0	0%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	0	0	0	0	0%
Ndertim KUN	0	0	0	178,500	0%


Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2020 shënuan rritje kundrejt vitit 2019 me rreth 5%, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2020 ishte rreth 85%. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

- ✿ Rrjeti rrugor rural
- ✿ Kujdesi social për familje dhe fëmijë
- ✿ Administrimi i bashkisë
- ✿ Zhvillimi i strehimit
- ✿ Menaxhimi i ujërave të zeza
- ✿ Arsimi bazë përfshirë parashkollorin
- ✿ Menaxhimi i mbetjeve

Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (000 Lekë)	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI 2020 në %
	927,076	1,187,036	815,159	1,032,700	79%



Dy fjalë mbi realizimin e investimeve

Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 815 milionë Lekë. Kundrejt vitit 2019 investimet janë ulur me rreth 31% kjo shpjegon uljen e kontributit të tyre në buxhet. Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2020 kundrejt planit është në masën 79%.

Investimet e bashkisë gjatë vitit 2020 kanë shënuar një hap cilësor në menaxhimin financiar:

- ✱ Investimet zënë në fund të vitit 2020 rreth 34% të buxhetit të bashkisë nga 51% në vitin 2019
- ✱ Projektet e investimeve kanë synuar përmirësimin e shërbimeve si: infrastrukturës rrugore, përmirësimi i hapësirave të gjelbërta publike, lyerje e institucioneve arsimore, projektet e rindërtimi pas tërmetit të dhjetorit 2019, institucionet arsimore (mesëm dhe bazë); furnizimin me ujë të pijshëm etj.

Treguesit Financiar

Treguesit Financiarë të shprehur në %	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	TRENDI I PERFORMANCËS
Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave	0.0%	15.8%	10.3%	0.0%	↑
Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve	45.9%	51.1%	33.5%	36.1%	↓
Norma e shpenzimeve korente ndaj totalit të shpenzimeve	54.1%	48.9%	66.5%	63.9%	↓
Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	23.3%	19.9%	21.8%	18.5%	↑
Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave	41.6%	39.6%	24.9%	31.3%	↓
Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave	34.4%	33.7%	20.8%	30.1%	↓
Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave	87.5%	96.3%	94.7%	99.7%	↓

Dy fjalë mbi treguesit kyç financiarë

Treguesit kyç financiarë japin një pamje të menaxhimit financiar të fondeve publike të bashkisë. Përtej tendencave vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve të bashkisë, këto tregues synojnë të japin informacion mbi qëndrueshmërinë financiare dhe performancën reale të bashkisë.


Përgjatë vitit 2020 financat e bashkisë karakterizuar nga:

- ✿ Ulja e detyrimeve të prapambetura të bashkisë kundrejt të tretëve nga 15% të totalit të ardhurave në 10% të tyre, duke shlyer një pjesë të mirë të borxheve që kishte trashëguar bashkia;
- ✿ Rritja e mbështetjes së shërbimeve sociale në tërësi
- ✿ Ulja e peshës së investimeve dhe rritja e peshës së shpenzimeve korente (për mirëmbajtje, paga; etj) në tërësinë e buxhetit të bashkisë
- ✿ Ulja e peshës së të ardhurave të veta të bashkisë në tërësinë e burimeve të financimit të buxhetit të saj
- ✿ Ekzekutimi i fondeve në dispozicion është ulur nga 96% në vitin 2019 në 95% deri në fund të vitit 2020.

Administrimi i bashkisë

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	123,754	5%	68%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin.

Figura 2: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investim

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
↓	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në numër kundrejt vitit të kaluar)		-7	20	20
↓	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	3%	1%	4%	3%
○	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)	1.43			0.55

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Ditë trajnimi në total	100			110
Numri total i personave të trajnuar	70			200

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fondi vjetor i pagave të punonjësve të bashkisë (në mijë lekë)		36,273	60,332	60,332
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	12	5	25	25
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	20	6	31	25
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	175	202	280	280
Numri total i punonjësve të bashkisë	720	747	825	825

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 68% të planit 2020. Bashkia shpenzon rreth 5% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2020 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti përshkak të përmetit dhe pandemisë. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2020 tregon se:

- ✿ Janë marrë më shumë masa disiplinore për punonjësit e bashkisë, për rrjedhojë kjo tregon probleme në respektimin e kuadrit ligjor dhe rregulloret e administratës;
- ✿ Është rritur numri i personave që kanë lëvizur nga puna duke zvogëluar qëndrueshmërinë e administratës;
- ✿ Ka vazhduar trajnimi i punonjësve të administratës edhe pse për shkak të pandemisë këto trajnime janë zhvilluar online, për rrjedhojë mungon grumbullimi i informacionit në lidhje me numrin e trajnimeve të realizuara.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Administrimi i bashkisë	37,453	25,732	7,562	21,815	35%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Blerje Printera/ Fotokopje			1,256	1,256	100%

Rrjeti rrugor rural

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
Realizimi faktik 2020	514,634	21%	84%



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërllokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor.

Figura 3: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korentë dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
→	Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në km linear)		0		0
↑	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mijë Lekë për 1 km rrugë rurale + urbane	1,124	1,306	827	983

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me cakull) në vit				472

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)	622	622	622	622
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në mijë Lekë:	699,071	812,257	514,634	611,640

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për mirëmbajtjen e gjithë rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj në masën 84% të planit 2020 në një vlerë prej 514 milionë Lekë ku investimet përfaqësojnë rreth 99% të tyre. Bashkia shpenzon rreth 21% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në rrjetin rrugor kanë çuar në përmirësimin e performancës së këtij shërbimi i cili tregon se:

- ✳ Bashkia ka investuar në mënyrë të rëndësishme për të përmirësuar gjendjen e rrjetit rrugor, vlerësohet se rreth 65% e tij është e shtuar / asfaltuar;
- ✳ Është mirëmbajtur rrjeti në pjesën urbane të bashkisë
- ✳ Është ulur (pothuajse përgjysmuar) kosto mesatare e 1 km linear rrugë të mirëmbajtur, duke përmirësuar kështu eficiencën e përdorimit të parasë publike.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Rrjeti rrugor rural	694,903	809,899	512,694	606,840	84%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Ndertim asfaltim rrugë në segmentin Babru Qender - Rrapi i Treshit "			2,649	2,649	100%
Blerje Peme dekorative të larta e të shkurtera+gjelb				15,612	0%
Investime KUN 2019				30,166	0%
Lyerje shkollash			1,493	1,672	89%
Mbikq Rrethimi I Varrezave Babru Qender			187	187	100%
Mbikqyres kolaudues			11,008	14,005	79%
Mobilim për (Shkollën -9 vjeçare "Vllazerimi")			7,523	7,523	100%
Nd. Rruget (Iliria+Burimi+Mreteresha Suzane)			14,586	29,172	50%
Nderim Rruga " Baz "+segmentet, Rruga " Horizonti "+Co plan, rrruga "Kastriotet", Rruga "Komsí", Rruga "Lis", Rruga "Luzni", Rruga "Vazhdim I Vllazerimit", Rruga "Lidhja e Prizerenit".			23,000	46,000	50%
Nderim segment rr. Ajet xhindoli paskuqan			216	216	100%
Ndertim K.U.N Paskuqan 2 Vreshte vazhdim loti trete			655	655	100%
Ndertim KUN Hali Hoxha			834	834	100%
Ndertim KUN Kamez 2019			8,000	8,000	100%


Ndertim KUN Mark Tirtja			900	900	100%
Ndertim Kun Ne Lagjen Prengjit +Kun mbrapa xhamise babru+Kun ndoc Dedaj+kun Memo Meta			419	419	100%
Ndertim KUN Paskuqan 2018			498	498	100%
Ndertim KUN Paskuqan 2019			9,603	9,603	100%
Ndertim KUN Rruga "Tirana" +Rruga Berati,			1,813	1,913	95%
Ndertim KUN Rruga Ali Kelmendi+Abaz Shehu Paskuqan 2			2,625	2,625	100%
Ndertim Kun rruga Argjinature +rruga Selenice			534	534	100%
Ndertim Kun rruga Buenos Aires+rruga Monte Karlo			609	609	100%
Ndertim KUN rruga Kosova +rr argjinatura likujdim pjesor			5,501	5,501	100%
Ndertim KUN rruga Muharrem Bajraktari Laknas			196	196	100%
Ndertim KUN rruga Mynih Kamza 4			743	743	100%
Ndertim Kun rruga Strasburg+KUN "Burimi"			404	404	100%
Ndertim Kun rruga Viktor Hygo+rruga Shekspir+rruga Fatmirsia			159	159	100%
Ndertim KUN Themistokli Germenji			681	681	100%
Ndertim KUN+KUB tek shkolla Jashar Hoxha Paskuqan 2 tek sheshi shkolles			57	57	100%
Ndertim Rrua " Zanave", "Kaltersia" (vazhdim +rruga "Bulqiza",+ segm rruga Arberit.			19,249	38,660	50%
Ndertim Rruga "Ibrahim Rugova" Vazhdim , rruga Mark Tirta+ Medi Frasherit, rruga Mithat Frasherit			20,579	41,157	50%
Ndertim Rruga "Konferenca e Mukje" zgjatimi I investimit ekzistues			15,769	31,762	50%
Ndertim Rruga "Macukull" Vazhdimi, Rruga "Gjallica", Rruga tek "Spahit"			10,551	24,568	43%
Ndertim Rruga "Sali Murat Vranishti"+rr."Hasan Zylfia"+rr.Kaci			12,705	25,455	50%
Ndertim Rruga " DRINI " Lagja nr.1 , Bathore			14,926	29,861	50%
Ndertim Rruga " Berzhite ", Zadrime dhe Azdreni			7,668	15,386	50%
Ndertim Rruga " Havzi NELA ", Ilia Kici+Jeronim Derada, Rruga Havzi Nela fillimi			15,210	28,420	54%
Ndertim Rruga " Konispol " ,rr. "Zef Llesh Doçi", rr." Lura" Lakna+KUB, rr.Tirana, rr. Berat +rr Fusha Sportit			29,083	50,654	57%
Ndertim Rruga " Liverpuli ", Rruga "Egnatia", Rruga "Strasburg", Rruga "Zogu I Pare", Rruga "Viktor Hygoi", Rruga "Eagle Mobile", Rruga "Ymer Prizereni", Rruga "Pjeter Bogdani+P.Sotiri", Rruga "Fatmiresia", Rruga "Ternova".			10,000	20,082	50%
Ndertim Rruga " Lushajve ", Rruga tek Stallat+Rr."LeonardoDavinçi", Rruga "Johan Shtraus", Rruga "Jani Vetro", Rruga Leonardo Davinçi, Rruga "Marije Kraja"+seg rr."Azem Hajdari", Rruga "Jeronim Derada", Rruga "Arni".			9,065	18,936	48%
Ndertim Rruga " Miqesia ", Rruga "Buenos Aires", Rruga "Murat Toptani".			22,049	39,097	56%
Ndertim Rruga " Oslo " Jane tre Segmente, Rruga "Drenove", Rruga "Altari", Rruga Demokracia loti I			13,100	27,030	48%
Ndertim Rruga " Shebeniku ",Rruga "Skenderbeu", Rruga "Fushe Muhur"			31,056	59,056	53%
Ndertim Rruga " Xiber ", Rruga "Ulez", Rruga "Berxulle", Rruga "Ndroq"			15,059	30,119	50%

Ndertim Rruga "Leskoviku", rruga Zhvillim, rruga Theth		5,000	14,257	35%
Ndertim Rruga "Vau Dejes " Bathore 5		5,213	5,213	100%
Ndertim Rruga "Zef Simoni " , ndertim vazhdim I rruges "Rozafa", ndertim rruga "Selenica"		8,464	16,928	50%
Ndertim Rruga Aleksandri i Madh + Muharrem Bajraktari , Rruga Abdyl Elmazi (zgjatim), Rruga Adem Jashari, Rruga Anton Zogaj,		9,681	19,832	49%
Ndertim rruga Argjinate + Monte Karlo		25,000	50,000	50%
Ndertim Rruga demokracia Lot II Bathore		42,745	70,449	61%
Ndertim Rruga Montekarlo, Kosova, zgjatim rruga Monarkia		13,500	29,904	45%
Ndertim Rruga Mustafa Lita		20,479	42,958	48%
Ndertim rruga Paskuqan 2 Vreshte vazhdim loti trete		1,825	1,825	100%
Ndertim rruga Peshkopia +Tomin		4,125	4,125	100%
Ndertim Rruga Sado Koshenko+ Rruga Sali Murati , Shtese Sali Murati , Rruga Kaci		1,910	4,162	46%
Ndertim rruga Ymer Haxhi Prizereni (Unaz) +nene Tereza+Veli dede+kun+Tajar Zavalani		2,748	2,748	100%
Ndertim Rruga zgjatim I rruges Gure+rruga Gjorice, rr.Dajti, Argjinatur, seg lidhes rruga Zana, Demokraci		5,199	5,199	100%
Ndertim rruga Zgjimi+KUN		1,148	1,148	100%
Ndertim shkolla 9-vjeçare Frutikulture		17,518	25,000	70%
Projekt pallati I Sportit		1,404	1,404	100%
Rehabilitimi Perforcim te banesave ekzistuese		4,625	4,625	100%
Rikonstruksion Rruga Kukesi, Rruga "Republika e Re"		14,955	29,911	50%
Rikonstruksion shkolla 9-vjecare "Nene Tereza"		9,841	10,000	98%
Riparim te soletave te shkollave e kopshteve		376	376	100%
Rivitalizim I Rruges "Bulevardi Blu" Urbane Kamez		9,718	9,718	100%
Rrethim I varrezave publike Babru Koder		740	740	100%
Rrethim I varrezave publike tek Reparti rruga konferanca e Mukjes Babru Koder tek Tunelet.		1,544	1,560	99%
Rruga " Abaz Ermenji " , rr. Ded Gjo Luli+degzim rr.Arben Broci mbi kanal, rruga Asim Zeneli		29,982	59,963	50%
Rruga konferenca e mukjes loti 3		6,000	12,000	50%
Rruga Rruga "Ali Kercyra"+ Rruga "Azem Galica"+rruga Abaz Shehu		4,000	8,214	49%
Sinjalistike dhe vijeimet per rruget Kamez		4,474	9,047	49%
T ndryshme Investime ne rruge			43,403	0%
Te ndryshme + mbikqyres kolaudues		347	9,377	4%
Te ndryshme + mbikqyres kolaudues (mbrojtja e lumit te Tiranes)		71	1,789	4%
TE TJERA INVESTIME			10,027	0%

Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë 509,851	Pesha ndaj totalit në % 21%	Realizimi Faktik 2020 100%
------------------------------	--------------------------------------	---------------------------------------	--------------------------------------

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për mbështetjen e familjeve dhe fëmijëve në nevojë.

Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për familjet dhe fëmijët: korente dhe investime

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Familje dhe fëmijë në nevojë të mbështetura nga bashkia	135	195		

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për familjet dhe fëmijët në nevojë sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve, në masën 100% kundrejt planit 2020. Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 21% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit tregon se bashkia ka vazhduar si edhe rritur mbështetjen për familjet dhe fëmijët në nevojë si :


- ✿ Familje dhe fëmijë me ndihmë ekonomike
- ✿ Fëmijë pa kujdes prindëror
- ✿ Gra dhe fëmijë viktime të dhunës

Është ulur numri për fëmijët e shërbyer në kopshte për shkak të situatës pandemike ku prindërit janë frenuar në frekuentimin si më parë të këtyre institucioneve.

Bashkia ka përfshirë në planet e saj të financimit në vitet e ardhshme ngritjen e 6 çerdheve për fëmijë, shërbim ky që mungon tërësisht në bashki.

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	191,774	8%	76%



Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
○	Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)	44%	43%		49%
○	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	22	21		21
○	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	29	28		29
○	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Mijë Lekë/institucion)	5,177	8,367		7,693

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor	123	128		135
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	34	34		35
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	502	490		490

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjec	2,612	2,500		2,890
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç	5,950	5,861		5,861
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	1,302	1,302		1,300
Mësues në sistemin parashkollor	117	133		136
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	663	650		670
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	14,311	13,665		14,000
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë (në mijë lekë)	176,006	284,481	191,774	252,751

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 76% të planit 2020. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet në shumën 37 milionë lekë kanë bënë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Të dhënat teknike për këtë program buxhetor për vitin 2020 mungojnë por bashkia do të grumbullojë dhe azhurnojë raportin në vijim. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 8% të buxhetit të saj. Shërbimi i arsimit parashkollor dhe atij bazë përgjatë vitit 2020 ka synuar të:

- ✿ Krijoje kushte të përshtatshme në shkolla për të ruajtur nivelin e frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✿ Të ruajë norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues edhe pse numri i nxënësve që frekuentojnë këtë sistem arsimor është rritur, nëpërmjet rritjes së numrit të mësuesve.
- ✿ Është ulë koston e një institucioni arsimor duke përmirësuar efiçencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim
- ✿ Investimet e realizuara përgjatë vitit synojnë përmirësimin e kushteve të punës së mësuesve dhe nxënësve. Investimet u realizuan në masën 59% të planit.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	60,348	138,279	37,098	63,368	59%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Investime Nd Pastrim Gjelberimit			645	2,170	30%
Ndertim shkolla 9-vjeçare Frutikulture				15,000	0%
Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare "Nene Tereza"				10,000	0%

Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	178,000	7%	100%



Qëllimi i programit buxhetor

Menaxhimi i ujërave të përdorura (zeza dhe bardha) / shërbimeve sanitare në përputhje me standardet mjedisore dhe ligjore.

Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve: korrente dhe investime

Shënim në shifrat më sipër janë paraqitur në total uji i pijshëm dhe kanalizimet ndërkohë që grafiku i referohet vetë kanalizimeve sanitare.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
→	Raporti i Popullatës së mbuluar me shërbim kundrejt totalit të popullatës (në %)	99.3%	100%	100%	100%
↑	Raporti i territorit të mbuluar me shërbim kundrejt totalit të territorit (në %)	70%	84%	87%	87%
→	Raporti të ardhurave nga tarifa kundrejt shpenzimeve totale për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (në %)	0%	0%	0%	0%

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plani 2020
Popullata e mbuluar me shërbim	103,461,	104,190	104,190	104,190
Territor i mbuluar me shërbim në km ²	28	33	34	34

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plani 2020
Buxheti për shërbimin e menaxhimit të ujërave të zeza dhe kanalizimeve (në mijë lekë)	77,628	58,345	36,858	51,219
Popullsia nën administrimin e bashkisë	104,190	104,190	104,190	104,190
Sipërfaqe totale e bashkisë në km ²	39	39	39	39

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transferimit dhe trajtimit të ujërave të bardha dhe të zeza (kanalizimeve sanitare), duke siguruar që shërbimi i ofrohet cdo familie dhe biznesi në të gjithë bashkinë në masën 72% të planit 2020. Bashkia kontribuon me investime për të përmirësuar shërbimin kryesisht në zonat rurale pasi ky shërbim është i konsoliduar tashmë në pjesën urbane të bashkisë. Përgjatë viteve të kaluara ashtu edhe në vitet në vijim do të vazhdojnë investimet për ngritjen dhe vënien në funksionim të kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të kanalizimeve sanitare, duke qenë një bashki me një urbanizim në rritje nga viti në vit. Investimet kapën vlerën mbi 51 milionë lekë, të cilat zënë rreth 2% të buxhetit të bashkisë. Performanca e këtij shërbimi tregon se:

- ✿ E gjithë popullata si në qytet ashtu edhe një fshat mbulohet me shërbim ndërkë që territori mbulohet mbi 90%.
- ✿ Bashkia po punon për të përmirësuar punën për mbledhjen e tarifës së shërbimit, pasi ky është një shërbim i cili duhet të ofrohet kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, e cila është në nivel shumë të ulët.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve	77,148	58,345	178,500	178,500	100%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Blerje Pompe për Nd. Ujësjellës Kanalizimeve			1,788	1,788	100%
Investime për zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve			35,070	49,431	72%
Ndertim Rrjeti i ujesjellesit dhe Ndertim KUN Demokracia-Bashkim Gazidede-Frutikulture Shkendija Shebeniku			96,800	96,800	100%
Mbikqyres ndertim Rrjeti i ujesjellesit dhe Ndertim KUN Demokracia-Bashkim Gazidede-Frutikulture Shkendija Shebeniku			1,200	1,200	100%
Ndertim Rrjeti i ukesjellesit dhe Ndertim KUN Demokracia-Bashkim Gazidede-Frutikulture Shkendija Shebeniku			80,500	80,500	100%
Mbikqyres ndertim Rrjeti i ujesjellesit dhe Ndertim KUN Demokracia-Bashkim Gazidede-Frutikulture Shkendija Shebeniku			500	500	100%

Menaxhimi i mbetjeve

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
Realizimi faktik 2020	97,383	4%	63%



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i mjedisit duke mirëmenaxhuar mbetjet urbane për të mbrojtur shëndetin e popullatës dhe krijuar kushte më të mira për shëndetin e popullatës.

Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Menaxhimi i mbetjeve: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i kushteve të jetesës së personave të sëmurë dhe me aftësi të kufizuar
Rritja ose përmirësimi i skema / institucioneve që ofrojnë shërbime për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
↓	Buxheti për menaxhimin e mbetjeve kundrejt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuar (Mijë Lekë për 1 tonë mbetje)	2.85	3.75	2.87	4.70
→	Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në qytet dhe Nj.Administrative (Ndryshimi vjetor në herë)	0	0	0	0
↑	Raporti i Popullatës së mbuluar me shërbim kundrejt totalit të popullatës (në %)	89%	89%	89%	91%
↓	Raporti të ardhurave nga tarifa kundrejt shpenzimeve totale për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (në %)	185%			180%

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
----------	------------	------------	-----------	------------

Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane (mesatare Q+NjA) -në qytet dhe Nj.Administrative	5	5	5	5
• Fekuenca në Qytet	7	7	7	7
• Frekuenca në Njësitë administrative	3	4	3	5
Popullsia e mbuluar me shërbim	92,985	92,985	92,985	94,853
• Popullsia e mbuluar me shërbim në Njësitë administrative	26,144	26,144	26,144	28,012
• Popullsia e mbuluar me shërbim në Qytet	66,841	66,841	66,841	66,841
Sasia totale të mbetjeve të menaxhuara (mbledhur + transferuar + trajtuar) në tonë.	23,725	30,000	33,990	32,989

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Buxheti për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve (në mijë lekë)	67,500	112,500	97,383	155,016
Popullsia totale nën administrimin e Bashkisë	104,190	104,190	104,190	104,190
• Popullsia në Njësitë administrative	37,349	37,349	37,349	37,349
• Popullsia në Qytet	66,841	66,841	66,841	66,841
Të ardhurat nga tarifat e shërbimit të mbetjeve	124,715	0		278,537

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për grumbullimin, transferimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane në qytet dhe njësitë administrative si edhe pastrimin e rrugëve në pjesën urbane të bashkisë në masën 63% të planit buxhetor për vitin 2020. Bashkia shpenzon rreth 4% të buxhetit për këtë shërbim. Performanca e shërbimit tregon se:

- ✿ Është ruajtur frekuenca e tërheqjes së mbetjeve nga kazanat e grumbullimit që ka vendosur bashkia, 1 herë në ditë në zonën urbane dhe 3 herë në javë në zonën rurale;
- ✿ Bashkia aktualisht mbulon rreth 90% të popullatës me shërbim;
- ✿ Edhe pse ka rritur sasinë e mbetjeve të grumbulluara dhe transferuara bashkia ka ulur koston mesatare të 1 tonë mbetje të menaxhuara nga 3,750 lekë në 2019 në vetëm 2,870 lekë në fund të vitit 2020. Kjo falë rritjes së eficiencës së menaxhimit të këtij shërbimi.

Shërbime publike vendore

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	92,032	4%	73%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i shërbimeve publike vendore për gjithë komunitetin e saj qoftë në qytet apo njësitë administrative.

Figura 8: Kategoritë e shpenzimeve për programin Shërbime publike vendore: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
→	Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)	10.26	10.3	10.3	10.3
↑	Rrënjë pemë dekorative (fondi i pemëve në hapësirat e gjelbërta (Ndryshimi vjetor në numër)		15,904	920	920
○	Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore (në %)	4%	0%		1%

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Rrënjë pemë të mbjella në vit	429	15,904	920	920
Sipërfaqe e gjelbëruar në vit në Km2		0		0

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fondi total i pemëve dekorative / gjelbëruese të bashkisë	2,300	18,204	19,124	19,124
Shpenzime për përmirësimin e shërbimit të varrezave publike (në mijë lekë)	0	0	0	5,000
Sipërfaqe totale e bashkisë në Km2	39	39	39	39

Sipërfaqe totale e e gjelbër publike në Km2	4	4	4	4
Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit (në mijë lekë)	17,865	8		5,300
Të ardhurat nga tarifat vendore (në mijë lekë)	436,756	387,873	254,046	309,792

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për gjelbërimin e hapësirave publike, shtimin dhe përmirësimin e trotuareve, mirëmbajtjen e varrezave publike, në masën 73% të planit të buxhetit për vitin 2020. Bashkia shpenzon rreth 4% të buxhetit për këtë shërbim. Bashkia investoi mbi 16 milionë lekë për përmirësimin e shërbimeve publike deri në fund të vitit 2020. Performanca e shërbimit tregon se:

- ✿ Është punuar për të mirëmbajtur hapësirat e gjelbërta, janë shtuar pemët dekorative brenda të njëjtave sipërfaqe të gjelbërta / rikrijuese të bashkisë;
- ✿ Me përmirësimin e cilësisë së rrjetit rrugor është punuar edhe për zgjerimin e rrjetit të trotuareve dhe gjendjes së tyre. Të dhënat konkrete mungojnë por bashkia do të grumbullojë informacion e në vijim do të pasurojë këtë raport.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Shërbime publike vendore	56,387	86,642	16,447	29,005	57%
Në mijë lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Blerje Kompjuterash			4,556	4,556	100%
Blerje kondicioner			264	264	100%
Blerje Makine MKZ			3,930	3,930	100%
Blerje Peme dekorative te larta e te shkurtera+gjelb			6,882	6,882	100%
Blerje Peme dekorative te larta e te shkurtera+gjelb 2020			6,377	14,813	43%
Hapje hapsirash publike + zhavorrim rruges (harta perkatese)			70	88	99%

Stehimi social

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
Realizimi faktik 2020	409,527	18%	94%



Qëllimi i programit buxhetor

Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.

Figura 9: Kategoritë e shpenzimeve për programin Strehimin social: korente dhe investime

Rindërtimi në mijë lek	2020 (plan)	2021 (fakt)
Grante rindërtimi	340,220	331,762
Bonus qeraje (tërmeti)	58,480	58,191
Total	398,700	389,953

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
Familie (persona të mbështetur me strehim social) ndryshimi vjetor në numër		0	831	831
Persona që përfitojnë bonus strehimi (ndryshimi vjetor në numër)		0	824	799
Persona që përfitojnë banesa sociale (ndryshimi vjetor në numër)	18	18	7	32

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Familie të mbështetura me strehim social nga të cilat:	24	24	855	855
- Persona të mbështetura me bonus strehimi	6	6	830	805
- Persona të mbështetura me strehim social	18	18	25	50

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

- Bashkia ka realizuar shpenzime për përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit si:
 - - ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
 - - pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë; administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit;
 - - promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit; të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë;
 - - përfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira, në masën 94% të planit të buxhetit për vitin 2020.

Bashkia shpenzon rreth 18% të buxhetit për këtë shërbim. Si rrjedhojë e tërmetit të nëntorit 2019 bashkia ka shpenzuar rreth 410 milionë lekë për strehimin social nga të cilat rreth 6 milionë lekë nga buxheti i vetë e pjesa tjetër rreth 403 milionë lekë nga transfertat e kushtëzuara të qëeverisë për këtë qëllim. Në këtë fond pjesën më të madhe e zënë mbështetja e familieve në nevojë me grantë rindërtimi dhe bonos qeraje për familiet e dëmtuara nga tërmeti. Rritja me gati 30 herë krahasuar e vitin 2019 vjen prej efekteve të tërmetit dhe mbështetjes përkatëse. Për vitin 2021 parashikohen rreth 302 milionë lekë fonde për rindërtim si grante rindërtimi apo fonde qeraje për familiet e dëmtuara. Performanca e këtij shërbimi për vitin 2020 tregon se:

- ✧ Është rritur numri i familieve të mbështetura me strehim social duke arritur në 855
- ✧ Është rritur numri i familieve të mbështetura me bonus qeraje dhe me banesa sociale.